



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:005158
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05736064

CAP.nr.1024/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren, Halide Reka, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit, K... R... e U.. “R... - D...”, Sh.a, me seli në Gjakovë, kundër debitorit A... J... K.. nga fshati B..., Komuna e R..., për shkak të përmbarimit të kërkesës në të holla-borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë- Dega në Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.16/2020, të datës 04.04.2023, jashtë seance me datë 27.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e kreditorit K... R... e Ujitjes “R.. – D...”, Sh.a, me seli në Gjakovë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë- Dega në Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.16/2020, të datës 04.04.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë- Dega në Rahovec, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktvendimin e ankimuar, PPP.Nr.16/2020, të datës 04.04.2023, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit A... J... K... nga fshati B..., Komuna e Rahovecit, e ka shfuqizuar urdhrin e përmbaruesit privat Gjokë Radi P.nr.1344/19 të datës 30.12.2019, sa i përket shumës së borxhit prej 1,484.76 €uro (njëmijë e katërqind e tetëdhjetë e katër euro e shtatëdhjetë e gjashtë cent), në emër të konsumimit të ujit për ujitje prej datës 31.12.2003 e deri me datë 31.12.2017, për shkak të arritjes së parashkrimit. Në pikën II të dispozitivit e ka lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin të përmbaruesit privat Gjokë Radi P.nr.1344/19 të datës 30.12.2019, me të cilin është caktuar përmbarimi, sa i përket shumës së borxhit prej 260.29 €uro (dyqind e gjashtëdhjetë euro e njëzetë e nëntë cent), në emër të konsumimit të ujit për ujitje për periudhën prej datës 01.01.2017 e deri me datë 30.12.2019, me kamatë ligjore 8%, nga dita e paraqitjes së propozimit, me datën 30.12.2019 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore. Në pikën III të dispozitivit ka vendosur

që ankesa kundër këtij aktvendimi, nuk e ndalon procedurën përbarimore, përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas nenit 78 të LPP-së.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar pala kreditore, për shkak të cenimit të dispozitave të LMD-së dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën e kreditorit, të anulohet aktvendimi i ankimuar duke e aprovuar në tërësi urdhrin e përbaruesit privat sipas propozimit të kreditorit ashtu që ta detyron debitorin të paguaj edhe pjesën e shfuqizuar të urdhrit përbarimor përkatësisht borxhin në vlerë prej 1,484.76 Euro me kamatë ligjore dhe shpenzimet procedurale.

Përgjigje në ankesën e kreditorit, ka paraqitur pala debitore me propozim që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e kreditorit, të vërtetohet aktvendimi i ankimuar.

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtarës individuale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori K... R... e U... "R... - D...", Sh.a, me seli në Gjakovë përmes përfaqësuesit të saj, ka paraqitur propozim për përbarim kundër debitorit, A... K... nga fshati B..., Komuna e Rahovecit, në bazë të dokumentit ekstraktit nga librat e kontabilitetit, me të cilën figuron se debitori i detyrohet kreditorit në borxh në shumën prej 1,745.05 Euro.

Përbaruesi Privat, Gjokë Radi, duke vepruar në bazë të propozimit për përbarim të kreditorit, me Urdhrin P.nr. 1344/19 të datës: 30.12.2019, ka lejuar përbarimin. Kundër urdhrin me të cilin është caktuar përbarimi, debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kontestuar urdhrin për caktimin e përbarimit, me pretendim se borxhi është parashkruar. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta aprovojë si të bazuar dhe urdhrin përbarimor ta shfuqizojë. Kreditori brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke theksuar se pretendimet e debitorit se ka arritur parashkrimin nuk qëndrojnë për faktin se debitori ka bërë pagesa në emër të borxhit dhe me këto veprime e ka ndaluar parashkrimin, me propozim për gjykatën që prapësimin e debitorit ta refuzojë si të pabazuar.

Gjykata shkallës së parë duke vendosur lidhur me propozimin për përbarim me aktvendimin e ankimuar PPP.Nr.16/2020, të datës 04.04.2023, e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se pas shqyrtimit dhe vlerësimit të prapësimin të debitorit, përgjigjes në prapësim të kreditorit si dhe shkresave tjera të lëndës ka ardhur në përfundim se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar. Gjykata e shkallës së parë me analizimin e propozimit për përbarim të datës 30.12.2019 dhe ekstraktit nga librat afariste ka vërtetuar faktin se debitori është konsumator me shifër 1261 dhe se i njëjti në emër të konsumimit të ujit për ujitje për periudhën prej datës 31.12.2003 e deri me datë 30.12.2019 ndaj kreditorit ka krijuar borxh shumën prej 1,745.05 Euro. Pretendimet e debitorit në prapësim se në këtë rast ka arritur parashkrimi i borxhit, gjykata e shkallës së parë i ka marrë si pjesërisht të bazuara, për shkak se për borxhin e krijuar nga data 01.12.2003 e deri me datë datën 30.12.2017 në shumën

prej 1,484.76 €uro ka kaluar afati një vjeçar brenda të cilit kreditorja ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit dhe ka arritur parashkrimi konform (LMD- Ligji Nr. 04/ L-077 10.maj.2012) nenit 341 paragrafi 1. ” *Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. par. 2. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit*” dhe nenit 360 par.1 “*Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake*” dhe neni 360 par. 2 e përcakton se: ”*Afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit, në të cilin arrihen kërkesat për pagesë*”. Debitori ka kryer pagesa kohë pas kohe dhe atë me datë 09.08.2010, 30.12.2010, 04.07.2011, 16.07.2012, 30.08.2013 dhe pagesa e fundit në shumën prej 25.00 €uro është bërë me datë 27.10.2014. Pas kësaj pagese debitori nuk ka kryer pagesa tjera, nuk ka lidhur ndonjë marrëveshje për pranim të borxhit. Me pagesën e fundit me datë 27.10.2014 debitori e ka ndërprerë parashkrimin edhe për borxhin e mëhershëm, mirëpo parashkrimi ka filluar të rrjedhë përsëri dhe deri në paraqitjen e propozimit për përmbarim (dt.30.12.2019) nuk ka pagesa tjera, nuk kemi ndonjë marrëveshje për pranim borxhi. Nga pagesa e fundit e debitorit, e deri me datë 30.12.2019 (koha e paraqitjes së propozimit për përmbarim) kanë kaluar më tepër se 4 (katër vite) dhe ka kaluar afati njëvjeçar brenda të cilit ka mundur të kërkojë përmbushja e borxhit. Për këto arsye gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi. Kreditori me paraqitjen e propozimit për përmbarim, me datën 30.12.2019 e ka ndaluar parashkrimin e borxhit vetëm për periudhën prej datës 01.01.2018 e deri me datën 30.12.2019, për shkak se parashkrimi fillon të rrjedh nga fundi i vitit kur të ketë arritur kërkesa për pagesë të borxhit, e që për këtë shumë nuk ka arritur parashkrimi. Kjo përcaktohet saktë sipas LMD-së nenit 369 ”*Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrur kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës*”. Për këto arsye gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Pretendimet e kreditorit për aplikim të gabuar të së drejtës materiale dhe cenimit të dispozitave të LMD-së, me arsyetim se kërkesa për furnizim me ujë për ujitjen e tokave bujqësore i referohet afatit të parashkrimit sipas nenit 353 të LMD-së e që këtu kemi të bëjmë me kërkesa periodike që rrjedhin vit për vit në afate të caktuara që parashkruhen për tri vite kurse në nenin 354 par.1 të LMD-së e drejta nga e cila rrjedhin kërkesat periodike parashkruhen për 5 vite nuk janë pranuar nga Gjykata e Apelit, sepse gjykata e shkallës së parë, drejtë ka konstatuar gjendjen faktike dhe pala kreditore nuk ka ofruar prova ose fakte të reja për të vendosur ndryshe. Në bazë të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve përkatësisht me dispozitën e nenit 360 par. 1 pika 1 përcaktohet se: “ *Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake*”, në këtë dispozitë nuk ceket se vlen vetëm për ujin e destinuar për pije, për këtë arsye këto pretendime ankimore nuk i aprovoi Gjykata e Apelit për shkak se me të drejtë ka vendosur gjykata e shkallës së parë kur ka konstatuar se borxhi pjesërisht është parashkruar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të ligjshëm, prandaj përfundimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe

Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e për të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1, pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

CAP.nr.1024/2023 dt. 27.05.2024

Gjyqtarja

Halide Reka